



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.34**

**7 prill**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 394 datë 10.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella” .....	1191
Ligj nr.10 395 datë 10.3.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin” .....	1198
Ligj nr.10 396 datë 17.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për transportin detar” .....	1199
Ligj nr.10 397 datë 17.3.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” .....	1205
Ligj nr.10 398 datë 17.3.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore” .....	1211
Ligj nr.10 399 datë 17.3.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar .....	1219
Udhëzim i përbashkët i MD dhe MF nr.4196/1, datë 17.3.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar .....	1226

**LIGJ**  
**Nr.10 394, datë 10.3.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKËSISË FETARE “VËLLAZËRIA  
UNGJILLORE E SHQIPËRISË” PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË  
NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësisë fetare “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6936, datë 23.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
BASHKËSISË FETARE UNGJILLORE “VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË “PËR  
RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe bashkësia fetare ungjillore “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” (më poshtë do të citohet VUSH), bazuar në parimet e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit fetar, të sanksionuara dhe të garantuara në nenet 10 e 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe në ligjet e tjera në fuqi (më poshtë, sipas rastit, do të citohen Kushtetuta, ligjet dhe/ose legjisllacioni në fuqi), lidhin Marrëveshjen si më poshtë (më poshtë do të citohet “Marrëveshja”).

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti**

Kjo Marrëveshje rregullon çështje të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit ndërmjet shtetit shqiptar dhe VUSH në të mirë të secilit dhe të të gjithëve, mbi bazën e parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të besimit fetar, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella.

## Neni 2 **Kuptimi**

VUSH është bashkësia e kishave dhe OJF-ve ungjillore (protestante) të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku janë organizuar individë që shfaqin e shprehin të njëjtat bindje e besime fetare.

## Neni 3 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

a) Të garantojë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë.

b) Të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të bashkësisë VUSH, të institucioneve dhe strukturave të saj, si dhe të personave juridikë të themeluar prej saj, për të zhvilluar lirisht misionin e saj fetar, edukativ, bamirës.

c) Të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe me Kushtetutën e ligjet në fuqi.

d) Të garantojë lirinë e individit për të zgjedhur ose ndryshuar fenë, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve fetare.

e) Të sigurojë lirinë e individit për të mos u ndalur dhe as detyruar të bëjë pjesë në bashkësinë VUSH, ose të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të saj.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohen në sigurimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo liri nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shtetit, të shëndetit e moralit politik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

## Neni 4 **Zbatimi i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje i shtrin efektet mbi të gjitha organet dhe institucionet shtetërore që kanë të bëjnë me fenë, bashkësinë VUSH, si dhe me institucionet dhe personat juridikë të themeluar prej kësaj bashkësie.

2. Individët ose grupimet e tyre përfitojnë nga të drejtat e parashikuara nga kjo Marrëveshje, kur marrin pjesë në VUSH.

## Neni 5 **Parimet të përgjithshme**

1. Shteti respekton dhe mbron bashkëjetesën fetare.

2. VUSH ka të drejtë të organizohet dhe të realizojë misionin e saj në mënyrë të pavarur nga shteti, duke respektuar parimin e laicitetit të shtetit, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

## Neni 6 **Bashkërendimi me organet shtetërore**

1. Komiteti Shtetëror për Kultet përfaqëson shtetin në marrëdhëniet e ndërsjella me bashkësinë VUSH, e cila bashkëpunon me Komitetin për realizimin e komunikimit aktiv të bashkësisë me organet dhe institucionet shtetërore.

2. Në marrëdhëniet me organet dhe institucionet shtetërore, VUSH përfaqësohet nga organet e caktuara prej saj, si dhe përdor vulën dhe shenjat e saj identifikuese.

## KREU II ORGANIZIMI DHE PERSONALITETI JURIDIK I BASHKËSISË FETARE

### Neni 7

#### **Bashkësia fetare dhe personat juridikë**

1. Shteti njeh dhe respekton personalitetin juridik të bashkësisë VUSH, të regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këtë Marrëveshje, si edhe të gjitha veprimet e deritanishme të kryera prej saj, për aq sa ato nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin.

2. Shteti shqiptar njeh dhe mbron të drejtat e veprimtarisë së bashkësisë VUSH.

3. VUSH e ka selinë në Tiranë, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë.

4. VUSH është organizuar në bazë të statutit të saj, miratuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

5. Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe mbarimi i bashkësisë VUSH, si person juridik, realizohen në përputhje me rregullat e traditat e kësaj bashkësie, me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

6. Shteti i njeh bashkësisë VUSH të drejtën për të krijuar institucione e struktura me karakter fetar ose jofetar, të cilat e fitojnë ose e kanë statusin e personit juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Institucionet e strukturat e krijuara nga VUSH mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e kësaj bashkësie, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon, ndërmjet të tjerave, edhe pajisjen me licenca dhe lejet përkatëse.

8. VUSH, me vullnetin e saj të lirë, mund të krijojë bashkime fetare të dy ose më shumë bashkësive, me qëllim për të realizuar synimet e përbashkëta. Këto bashkime fetare e fitojnë personalitetin juridik pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në gjykata, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

9. VUSH, si dhe organizatat e tjera që krijon për ushtrimin e veprimtarisë së saj, në të gjitha format e ligjshme të organizimit të tyre, janë persona juridikë jofitimprurës.

### Neni 8

#### **Personaliteti juridik**

1. VUSH njihet si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesa për regjistrimin e personit juridik, paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i bashkësisë VUSH;

b) Akti i themelimit të personit juridik, i firmosur nga përfaqësuesi ligjor i bashkësisë VUSH, sipas rregullave të saj, ku ndërmjet të tjerave, përcaktohen selia, natyra dhe objekti i veprimtarisë.

c) Statuti i personit juridik sipas rregullave të bashkësisë VUSH, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen struktura e organizimit, organet, drejtuesit dhe funksionarët, si dhe mënyra e emërimit dhe e zgjedhjes së tyre, përfaqësuesit ligjorë të saj, detyrat dhe kompetencat përkatëse, burimet e financimit dhe mënyra e mbarimit të personit juridik.

d) Mendimi i dhënë nga Komiteti Shtetëror për Kultet, i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të kërkuarit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, të shoqëruar me dokumentet e sipërpërmendura, bën njohjen e personit juridik dhe regjistrimin e tij, nëpërmjet vendimit përkatës në regjistrin e bashkësive dhe organizatave fetare në këtë gjykatë.

#### Neni 9

### **Afati dhe territori i veprimtarisë së personave juridikë të bashkësisë fetare**

VUSH dhe personat juridikë të krijuar prej saj, mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre me afat të pakufizuar, në një pjesë ose në të gjithë territorin, si dhe për ushtrimin e lirisë së besimit të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, sipas përzgjedhjes së vetë bashkësisë dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi në vendet respektive.

#### Neni 10

### **Parimet e organizimit dhe të veprimtarisë**

1. Palët angazhohen për respektimin e parimeve kushtetuese mbi të cilat ndërtohet kjo Marrëveshje dhe do të punojnë së bashku për zbatimin e legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Shteti respekton pavarësinë e bashkësisë “Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë” për t’u organizuar e ushtruar veprimtarinë e saj, si dhe për të administruar pasuritë që zotëron, në bazë të parimeve, rregullave, traditave (kanoneve) dhe statutit të saj.

3. Parimet, rregullat, kanonet dhe statuti i bashkësisë VUSH dhe veprimtaria e saj respektojnë interesat kombëtarë, bashkëjetesën dhe tolerancën fetare ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri, në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 11

### **Organizimi i VUSH**

1. Në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e bashkësisë VUSH përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin.

2. VUSH ka të drejtë të formojë organet e saj, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit në mënyrë të pavarur, në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin e saj.

3. Përpara shpalljes publike të titullarit të caktuar, si dhe të ndryshimeve në strukturat e saj drejtuese, VUSH njofton Komitetin Shtetëror për Kultet.

4. Funksionarëve, drejtuesve dhe organeve të bashkësisë VUSH, u garantohet liri e plotë e ushtrimit të veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e kësaj bashkësie, për aq sa kjo veprimtari nuk vjen në kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor.

#### Neni 12

### **Marrëdhëniet me bashkësitë e huaja fetare**

1. VUSH ka të drejtë të krijojë dhe të mbajë kontakte me bashkësi fetare të një vendi tjetër ose ndërkombëtare, të marrë pjesë në veprimtarinë e tyre fetare e bamirëse, për aq sa këto kontakte nuk bien ndesh me rendin e brendshëm kushtetues.

2. VUSH ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare dhe/ose materiale nga entitete dhe/ose individë të huaj, për aq sa kjo mbështetje nuk bie ndesh me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

## **KREU III STATUSI FINANCIAR**

#### Neni 13

### **Regjistrimi në organet tatimore**

VUSH, si dhe personat juridikë të bashkësisë regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat 1194

tatimore të Republikës së Shqipërisë”. Në rast se bashkësitë fetare, krahas veprimtarisë me karakter fetar, dëshirojnë të kryejnë dhe veprimtari me karakter ekonomik, detyrohen të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

#### Neni 14

#### **Statusi juridik dhe fiskal**

1. VUSH, si dhe personat e saj juridikë përjashtohen nga të gjitha llojet e taksave:

a) Subvencionet financiare të çfarëdolloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si dhe donacionet materiale të destinuara për të realizuar misionin e vet, kur këto të ardhura apo donacione nuk përdoren për përfitime nga organizatorët.

b) Ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të bashkësisë VUSH ose të personave juridikë të themeluar prej saj, të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin fetar, veprimtarinë baritore, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera fetare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të bashkësisë VUSH.

c) Taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat i dhurohen bashkësisë VUSH, ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë bashkësisë.

2. Personat juridikë të themeluar nga VUSH, por që nuk e kanë zotësinë juridike ose nuk janë regjistruar si organizata jofitimprurëse përpara ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën që të regjistrohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, brenda dy vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi.

3. Përjashtohen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor personeli fetar dhe laik në shërbim të bashkësisë VUSH, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre dhe që i kanë derdhur këto kontribute në vendet e origjinës.

4. VUSH, për personelin klerik dhe laik të saj, si kategori profesionale krejt e veçantë, miraton strukturën e pagave, për efekt kontributesh të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e personit.

5. Për veprimtaritë me karakter institucional, si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi i komunitetit, veprimtaria fetare, humanitare dhe bamirëse, formimi i klerit, mësimi i teologjisë dhe i shkencave fetare, VUSH dhe personat juridikë të themeluar prej saj nuk janë të detyruar të mbajnë regjistër kontabël dhe t’u nënshtrohen standardeve administrative të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë çështje. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrim që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërorë të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

#### KREU IV

#### **BASHKËPUNIMI NË TË MIRË TË SHTETASVE**

#### Neni 15

#### **Festat fetare**

1. Ditët e festave fetare që do të jenë ditë pushimi, vendosen me ligj. VUSH mund të propozojë festa fetare që, sipas mendimit të saj, mund të shpallen ditë pushimi.

2. VUSH, në përputhje me nevojat fetare të besimtarëve, ka të drejtë të përcaktojë edhe festa të tjera veç atyre që do të trajtohen me ligj si festa zyrtare, të cilat nuk janë të detyrueshme për sektorin shtetëror publik dhe privat.

## Neni 16

### **Institucionet edukative dhe arsimore**

1. VUSH ka të drejtë, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrrejë dhe të administrojë institucione edukative dhe arsimore të të gjitha niveleve.

2. Shteti dhe VUSH angazhohen të garantojnë të drejtën e individëve për t'u arsimuar pa asnjë dallim, përfshirë edhe arsimin fetar, duke respektuar të drejtën e prindërve për të siguruar edukimin e fëmijëve në përputhje me bindjet e tyre.

3. Shteti e njeh vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore fetare, sipas kriterëve të caktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin.

4. Gjatë procesit mësimdhënës, shteti dhe VUSH angazhohen që arsimimi i fëmijëve të bazohet mbi të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, të drejtohet në përgatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe vëllazërisë midis njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare, ose personave me origjinë tjetër, duke iu kundërvënë racizmit e fanatizmit.

## Neni 17

### **Kryerja e veprimtarive sociale**

VUSH ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sociale me karakter ekonomik, edukativ e shëndetësor. Kjo e drejtë përfshin edhe krijimin e mjediseve sociale të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 18

### **Organizatat bamirëse**

VUSH mund të themelojë organizata bamirëse, duke respektuar rregullat e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi.

## Neni 19

### **Liria e shprehjes dhe e drejta për informim**

1. Shteti dhe VUSH njohin dhe pranojnë mjetet e informimit publik si një element të rëndësishëm për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të ndërgjegjes.

2. VUSH ka të drejtë të shprehë dhe të përhapë lirisht bindjet e saj nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik, medias së shkruar dhe asaj pamore, si dhe në çfarëdo formë tjetër të njohur sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. VUSH ka të drejtë të themelojë struktura të komunikimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, përmbajtja që jepet përmes mjeteve të komunikimit masiv nuk duhet të përshkohet nga ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare, ose që diskriminojnë bashkësitë fetare dhe nxitin grindje ndërfitare.

4. VUSH ka të drejtë të shprehë nëpërmjet mjeteve të komunikimit dhe informimit publik.

5. Komiteti Shtetëror për Kultet bashkëpunon me VUSH për nevoja studimore e informuese.

## Neni 20

### **Objektet e kultit**

1. Ndërtesat dhe objektet që shërbejnë për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të shenjta nga VUSH. Ndërhyrja e autoriteteve shtetërore në to është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet në zbatim të një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv, ose në rast të kanosjes së një rreziku të afërm.

2. Paprekshmëria e hapësirës publike garantohet nga shteti.

3. Organet kompetente shtetërore, në bashkëpunim me VUSH, përcaktojnë vendin për ndërtimin e objekteve të reja të kultit dhe vendosjen e simboleve fetare, në përputhje me planet rregulluese urbanistike dhe kriteret që parashikon ligji nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

## KREU V ÇËSHTJET E PRONËSISË

### Neni 21 **E drejta e pronës**

1. Shteti i njeh bashkësisë VUSH të drejtën e pronës mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme.

2. Shteti do të trajtojë me përparësi kërkesat e bashkësisë VUSH për kthimin dhe kompensimin e pronave të veta, si dhe kryerjen e legalizimeve dhe dhënien e lejeve të shfrytëzimit, nëse është rasti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 22 **Mbrojtja e trashëgimisë kulturore fetare**

1. Republika e Shqipërisë njeh trashëgiminë morale dhe pasurore të besimit që përfaqëson VUSH.

2. Objektet e kultit që kanë statusin e monumentit të kulturës, i kthehen në pronësi ose përdorim bashkësisë VUSH dhe për çdo ndërhyrje të mundshme, të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Shteti mund të marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interesat madhorë në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

4. Këshilli i Ministrave, duke u bazuar edhe në mendimin e bashkësisë fetare ungjillore VUSH, bashkërendon përpjekjet në të ardhmen, për të evidentuar, vlerësuar e mbrojtur pasuritë kulturore, si dhe godinat e kultit të bashkësisë VUSH, që bartin vlera kulturore kombëtare materiale e shpirtërore.

5. Shteti lejon ushtrimin e veprimtarisë fetare në një objekt të kultit që është trashëgimi kulturore kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 23 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, si dhe zgjidhja e çështjeve të diskutueshme, bëhen mbi bazën e mirëkuptimit midis palëve.

2. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me mirëkuptim e marrëveshje midis palëve.

3. Për të gjitha çështjet e përbashkëta në të cilat do të ketë mendime të ndryshme, VUSH dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të gjejnë një qëndrim të njëjtë, duke pranuar ndërmjetësimin e Komitetit Shtetëror për Kultet për zgjidhjen e gjithëpranuar.

### Neni 24 **Dispozita të fundit**

1. Shteti i njeh të drejtën bashkësisë VUSH që të lidhin marrëveshje të veçanta për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.



2. Kjo Marrëveshje shërben si akt bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta me bashkësinë VUSH, që do të miratohen sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Marrëveshjet e veçanta që lidhen me bashkësinë VUSH në bazë të kësaj Marrëveshjeje, regjistrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Secila palë mund ta denoncojë me shkrim Marrëveshjen. Në rast të tillë, Marrëveshja do të skadojë në ditën e nëntëdhjetë (90) pas dorëzimit të njoftimit për përfundimin, palës tjetër.

5. Marrëveshja do të hyjë në fuqi pasi të kenë përfunduar procedurat e nevojshme ligjore për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**PRESIDENTI I VËLLAZËRISË UNGJILLORE  
SHQIPTARE  
PASTOR  
Fitor Muça**

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË  
DHE SPORTEVE  
Ferdinand Xhaferaj**

### **LIGJ**

**Nr.10 395, datë 10.3.2011**

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 186, DATË 5.11.2009 “PËR RREGULLIMIN E PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

#### **Neni 1**

Në nenin 3 të kreut I bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi ekzistues numërohet pika “1”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Personat e stimuluar, që kanë përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë dhe e zhvillimit, në rast se nuk paraqesin interes për ndryshimin e pronësisë së truallit, nuk u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj.”.

#### **Neni 2**

Në nenin 5 të kreut II bëhet shtesa e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “dh” të pikës 1 shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Turizmit për detyrimet nga marrëveshja e qirasë.”.

#### **Neni 3**

Në nenin 14, pika 6 hiqet.

#### Neni 4

Pas nenit 15 të kreut III shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 15/1

1. Për personat e stimuluar ose subjektet me marrëveshje qiraje dhe zhvillimi, që nuk kanë përmbushur detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë, në çmimin e kalimit të pronësisë mbi truallin shtohet dhe vlera e detyrimeve të prapambetura. Detyrimet e prapambetura llogariten nga Agjencia Kombëtare e Turizmit.

2. Të ardhurat nga qiratë ndahen dhe përdoren sipas legjislacionit në fuqi.”.

#### Neni 5

#### **Dispozita kalimtare**

1. Për kërkesat e depozituara nga personat e stimuluar, për të cilat ka nisur procedura e shqyrtimit, ALUIZNI kërkon nga Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe nga personi i stimuluar një vërtetim për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë dhe e zhvillimit.

2. Agjencia Kombëtare e Turizmit, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, i dërgon ALUIZNI-t listën e detyrimeve të qirasë që kanë personat e stimuluar.

3. ALUIZNI nuk lejohet të kryejë procedura shqyrtimi për subjektet e parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6937, datë 23.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

#### **LIGJ**

**Nr.10 396, datë 17.3.2011**

#### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR TRANSPORTIN DETAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

#### Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për transportin detar”.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6958, datë 4.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

### **MARRËVESHJE**

#### **NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI TRANSPORTIN DETAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

*me dëshirën* dhe interesin e përbashkët dypalësh për krijimin e një baze ligjore të vazhdueshme për zhvillimin e marrëdhënieve reciproke tregtare nëpërmjet transportit detar, për të siguruar zhvillimin e tregtisë së lirë dhe rritjen e nivelit të mundësive të marrëdhënieve ndërkombëtare në këtë fushë;

*të ndërgjegjshëm* për faktin se shkëmbimi dypalësh i mallrave duhet të shoqërohet nga shkëmbimi efektiv i shërbimeve, i cili bazohet në parimin e konkurrencës;

*duke iu referuar* Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit, si dhe konventave ndërkombëtare mbi sigurinë e transportit detar, lehtësimin e transportit detar ndërkombëtar, kushtet e jetesës dhe të punës së detarëve, transportin e mallrave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit detar;

*duke pasur parasysh* detyrimet e Republikës Federale të Gjermanisë si shtet anëtar i Bashkimit Europian,

bien dakord si më poshtë.

## Neni 1

### **Përkufizimi i termave**

Në këtë Marrëveshje:

1. Termi “anije e një pale kontraktuese” nënkupton çdo anije, e cila sipas dispozitave ligjore të kësaj pale kontraktuese mban flamurin e saj dhe është shënuar në një regjistër, në përputhje me ligjet e asaj pale. Për zbatimin e neneve 3, 5, 11, 12 dhe 13 konsiderohet si anije e një pale kontraktuese edhe çdo anije, e cila mban flamurin e një shteti të tretë dhe përdoret nga një kompani e transportit detar e një pale kontraktuese.

2. Termi “sipërmarrje e transportit detar e një pale kontraktuese” nënkupton një kompani transporti, e cila përdor anije të transportit detar dhe ka selinë e saj të regjistrimit në territorin e kësaj pale kontraktuese.

3. Termi “anëtar i ekuipazhit” nënkupton kapitenin dhe çdo person tjetër, i cili gjatë udhëtimit duhet të kryejë detyra dhe shërbime në bordin e anijes.

4. Termi “autoritetet kompetent i transportit detar” nënkupton:

a) në Republikën Federale të Gjermanisë, Ministrinë Federale të Transportit, Ndërtimit dhe Zhvillimit Urban, si dhe autoritete, që varen prej saj;

b) në Republikën e Shqipërisë, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe autoritetet që varen prej saj.

## Neni 2

### **Konventat ndërkombëtare**

Marrëveshja aktuale nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare të nënshkuara prej secilës palë.

### Neni 3

#### **Liria e qarkullimit, mosdiskriminimi**

1. Një anije e një pale kontraktuese do të ketë të drejtën të lundrojë ndërmjet çdo porti të hapur për transportin ndërkombëtar, në territorin e secilës nga palët kontraktuese dhe të transportojë udhëtarë dhe mallra ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese, si dhe ndërmjet secilës prej tyre dhe shteteve të treta.

2. Palët kontraktuese nuk do të ndërmarrin asnjë veprim që do të ishte i dëmshëm për pjesëmarrjen e pakufizuar të kompanive të transportit detar të një pale kontraktuese në transportin detar, në transportin e mallrave ndërmjet vendeve të tyre, si dhe ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve të treta. Këtu gjejnë zbatim parimet e mosdiskriminimit, konkurrencës së lirë dhe të zgjedhjes së lirë të kompanisë së transportit detar.

3. Me kusht respektimin e parimit të reciprocitetit, kompanitë e transportit detar nga vende të treta dhe anijet, që mbajnë flamurin e shteteve të treta, mund të marrin pjesë pa asnjë kufizim në transportin e mallrave, që shkëmbehen brenda kuadrit të tregtisë së jashtme të palëve kontraktuese.

### Neni 4

#### **Masat për lehtësimin e transportit detar**

1. Palët kontraktuese do të marrin, brenda kuadrit të tyre ligjor, të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar dhe ndihmuar transportin detar, për të shmangur çdo zgjatje në qëndrimin e anijeve në port, dhe të shpejtojnë e thjeshtëzojnë brenda mundësive formalitetet doganore dhe të tjera formalitete, që duhen marrë në konsideratë në porte, si dhe përdorimin e mjediseve dhe shërbimeve ekzistuese për eliminimin e mbeturinave.

2. Palët kontraktuese marrin përsipër që me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të anulojnë të gjitha masat e njëanshme administrative teknike dhe të tjera, që sjellin një kufizim indirekt dhe kanë efekte diskriminuese në ofertën e lirë të shërbimeve në transportin detar ndërkombëtar. Secila palë kontraktuese merr përsipër, gjithashtu, që të mos marrë ose zbatojë asnjë masë administrative, teknike ose legjislative që mund të ndikojë në mënyrë diskriminuese ndaj qytetarëve ose kompanive të palës tjetër kontraktuese në realizimin e shërbimeve në transportin detar ndërkombëtar.

### Neni 5

#### **Trajtimi i barabartë i anijeve**

Mbi bazat e parimit të reciprocitetit, secila palë kontraktuese do t'u garantojë anijeve të palës tjetër kontraktuese, kur janë në port, ujërat territoriale dhe ujërat e tjera nën juridiksionin e saj, të njëjtin trajtim siç u garanton anijeve të saj të angazhuara në transportin detar ndërkombëtar. Kjo do të zbatohet në mënyrë të veçantë për:

- hyrjen në porte;
- qëndrimin në porte dhe largimin prej tyre;
- përdorimin e mjediseve portuale për transportin e mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe gjithashtu për aksesin në të gjitha shërbimet dhe mjediset e tjera;
- mbledhjen e tarifave dhe pagesave portuale.

### Neni 6

#### **Aktivitetet tregtare**

1. Mbi bazën e parimit të reciprocitetit, secila palë kontraktuese do t'u garantojë kompanive të transportit detar të palës tjetër kontraktuese të drejtën e ngritjes dhe të mbajtjes së degëve në territorin e tyre, me qëllim ushtrimin dhe përdorimin e shërbimeve të agjencive dhe të speditonit, si dhe të punësimit të personelit administrativ, kontabël dhe teknik për këto qëllime.

2. Në procesin e krijimit të degëve dhe punësimit të personelit do të ndiqen ligjet dhe rregullat e palës kontraktuese pritëse, sikurse ligjet dhe rregullat e tjera për hyrjen e të huajve dhe qëndrimin e tyre në territorin e palës kontraktuese pritëse. Pavarësisht nga sa më lart, personeli i punësuar në këto degë nuk ka nevojë për leje punësimi.

3. Çdo person i punësuar nga një palë kontraktuese sipas dispozitave të paragrafit 2 më sipër, do të riatdhesohet nga pala tjetër kontraktuese, kur pala kontraktuese pritëse njofton palën tjetër kontraktuese, që qëndrimi i personit në fjalë në territorin e saj është bërë i paligjshëm.

#### Neni 7

### **Transferimi i pakufizuar i parave**

Secila palë kontraktuese do t'u garantojë kompanive të transportit detar të palës tjetër kontraktuese të drejtën për të përdorur të ardhurat e fituara nga shërbimet e transportit detar në territorin sovran të palës kontraktuese të përmendur më parë, duke përfshirë organizimin dhe zbatimin e transporteve të mëparshme dhe të mëpasshme të lidhura me këto shërbime, për qëllim pagesash që kanë të bëjnë me transportin detar. Këto të ardhura mund të transferohen jashtë vendit lirisht dhe pa asnjë kufizim, në çdo valutë të konvertueshme, sipas kursit zyrtar të këmbimit.

#### Neni 8

### **Sektorët e përjashtuar nga fusha e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje**

1. Kjo Marrëveshje nuk gjen zbatim në rastin e anijeve të luftës dhe mjeteve të tjera lundruese, që kanë funksione statutorë, si dhe as në rastin e mjeteve të peshkimit.

2. Kërkimet shkencore detare do të orientohen nga dispozitat thelbësore të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit. Një anije kërkimesh do të trajtohet si anije e një pale kontraktuese në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje, kur ajo hyn në një port të palës tjetër kontraktuese për qëllime bunkerimi ose rifurnizimi, si dhe në rastet kur është e përfshirë në një aksident detar.

3. Kjo Marrëveshje nuk prek ligjet dhe rregullat e secilës palë kontraktuese, që lidhen me privilegjet e flamurit kombëtar për sa i përket lundrimit kombëtar bregdetar, si dhe shpëtimin, rimorkimin, pilotimin dhe shërbimet hidrografike, të cilat u rezervohen secilës kompani kombëtare ose kompanive të tjera të palëve dhe shtetasve të saj.

4. Mbështetur në dispozitat e nenit 9 (2) dhe nenit 13 (2), përcaktimet e kësaj Marrëveshjeje nuk do të shtrihen në fushën e tatimeve.

#### Neni 9

### **Respektimi i dispozitave ligjore**

1. Me kusht respektimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit, një anije e secilës palë kontraktuese dhe anëtarët e ekuipazhit të saj, u nënshtrohen gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese, ligjeve dhe rregullave në fuqi të asaj pale kontraktuese.

2. Pasagjerët dhe dërguesit e mallrave duhet të respektojnë ligjet dhe rregullat në fuqi të secilës palë kontraktuese lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe daljen e udhëtarëve, si dhe lidhur me importimin, eksportimin dhe magazinimin e mallrave, në mënyrë të veçantë dispozitat lidhur me daljen në tokë, emigrimin, doganat, taksat dhe karantinën.

#### Neni 10

### **Njohja e ndërsjellë e dokumenteve të anijes**

1. Dokumentet e anijes të secilës palë kontraktuese, të cilat janë lëshuar ose janë njohur në përputhje me konventat më të rëndësishme ndërkombëtare, kur mbahen në bord, do të njihen nga pala tjetër kontraktuese.

2. Anijet e secilës palë kontraktuese, që mbajnë një certifikatë tonazhi ndërkombëtare (1969) të vlefshme, të lëshuar sipas dispozitave të Konventës ndërkombëtare mbi tonazhin e anijeve, 1969, do të përjashtohen nga matjet e mëtejshme të tonazhit në portet e palës tjetër kontraktuese. Në rastet kur për llogaritjen e shumës së çdo pagese, takse ose tarife, kërkohet tonazhi i anijes, atëherë si bazë për këtë do të merret tonazhi i dhënë në certifikatën ndërkombëtare të tonazhit.

#### Neni 11

### **Dokumentet e udhëtimit të anëtarëve të ekuipazhit**

1. Për anëtarët e ekuipazhit, pavarësisht nëse ata janë shtetas të një pale kontraktuese ose të një shteti të tretë, do të konsiderohen si dokumentet e pranueshme për kalimin e kufirit ato dokumente të lëshuara nga autoritete kompetente, që mund të përdoren për kalimin kufitar sipas legjislacionit të palës kontraktuese, kufiri i së cilës do të kalojë.

2. Dokumentet identifikuese për detarët, të cilat vihen në përdorim nga një palë kontraktuese pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe që u japin zotëruesve të tyre të drejtën për kalimin e kufirit, do të njihen nga pala tjetër kontraktuese, kur ato plotësojnë kushtet e shtetit përkatës për t'u njohur si dokument për kalimin e kufirit. Secila palë kontraktuese njofton me notë palën tjetër kontraktuese lidhur me njohjen përkatëse.

#### Neni 12

### **Hyrja, kalimi tranzit dhe qëndrimi**

1. Secila palë kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi të vendit pritës, u jep leje atyre anëtarëve të ekuipazhit të një anijeje të palës tjetër kontraktuese, të cilët janë zotërues të një dokumenti të kalimit kufitar, të vlefshëm sipas nenit 11, për të dalë në tokë dhe për të qëndruar në zonën portuale gjatë kohës së qëndrimit të anijes së tyre.

2. Kur është e nevojshme, autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në vendin pritës, u lëshojnë atyre anëtarëve të ekuipazhit të një anijeje të palës tjetër kontraktuese, të cilët janë mbajtës të një dokumenti të vlefshëm të kalimit kufitar sipas nenit 11 të mësipërm një vizë:

- për qëllim riatdhesimi;
- për të shkuar në bord të anijes së vet ose të një anijeje tjetër;
- për çdo arsye tjetër, që gjykohet e vlefshme nga autoritetet kompetente të palës tjetër kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese do t'i lejojnë çdo anëtar të ekuipazhit të një anijeje të një pale kontraktuese, i cili është shtruar në spital në territorin e palës tjetër kontraktuese, të qëndrojnë atje gjithë periudhën e nevojshme të trajtimit të tij si pacient.

4. Secila palë kontraktuese rezervon të drejtën të refuzojë hyrjen e personave të padëshirueshëm në territorin e saj, edhe pse këta persona mbajnë një dokument udhëtimi të specifikuar në nenin 11 të mësipërm.

5. Secila palë kontraktuese merr përsipër që të kthejë mbrapsht, pa asnjë formalitet, çdo person që ka hyrë në territorin e palës tjetër kontraktuese nga bordi i një anijeje të palës së parë kontraktuese, kur një person i tillë nuk përmbush ose nuk përmbush më kushtet e hyrjes ose qëndrimit të vlefshëm në territorin e palës tjetër kontraktuese.

6. Punonjësit e përfaqësive diplomatike dhe konsullore të një pale kontraktuese dhe anëtarët e ekuipazhit të anijeve të kësaj pale kontraktuese kanë të drejtën që, duke respektuar ligjet dhe rregullat përkatëse në fuqi në vendin pritës, të kontaktojnë dhe takohen me njëri-tjetrin.

7. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 deri 6 të mësipërm, rregullat e palëve kontraktuese lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe nisjen e të huajve do të mbeten të paprekura.

Neni 13  
**Incidentet në det**

1. Nëse një anije e secilës palë kontraktuese ka rënë në cektinë, është mbytur ose ka pësuar një avari të caktuar ndërsa është në ujërat territoriale të palës tjetër kontraktuese, autoritetet e palës së fundit kontraktuese do t'u japin anëtarëve të ekuipazhit dhe udhëtarëve të kësaj anijeje, si dhe anijes dhe ngarkesës së saj të njëjtën mbrojtje dhe mbështetje sikurse anijeve, që mbajnë flamurin e tyre.

2. Në rastin e një incidenti detar në kuptimin e paragrafit 1 të këtij neni, të dy palët kontraktuese nuk do të marrin taksat e importit, në mënyrë të veçantë taksat e konsumit, mbi ngarkesën, pajisjet, furnizimet, rezervat ushqimore dhe objektet e tjera, për sa kohë që këta artikuj nuk janë përdorur ose konsumuar në territorin sovran të palës përkatëse kontraktuese. Dega kompetente doganore duhet të informohet pa vonesë për avarinë detare. Kushtet për magazinim të përkohshëm pa detyrim pagese të tarifave të importit të mallrave në fjalë do të vendosen bashkërisht nga palët mbi baza reciprociteti.

3. Palët kontraktuese marrin përsipër që, me kërkesë të palës tjetër dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj të secilës palë kontraktuese për mbështetjen e sigurisë së anijeve dhe mbrojtjen e mjedisit detar, të bashkëpunojnë lidhur me hetimin e avarive detare, për të cilat të paktën një palë kontraktuese ka vendosur që të jetë përgjegjëse në kuptimin e paragrafit 6 të Kodit të IMO për hetimin e avarive dhe incidenteve në det. Një bashkëpunim i tillë synon në veçanti të lehtësojë, në rast nevoje, lidhjen e marrëveshjeve të parashikuara në këtë Kod.

Neni 14  
**Bashkëpunimi**

Palët kontraktuese inkurajojnë kompanitë e transportit detar dhe institucionet e transportit detar në secilin vend të nxisin dhe të zhvillojnë bashkëpunimin midis tyre. Kjo vlen në veçanti për çështjet teknike dhe për kualifikimin e specialistëve.

Neni 15  
**Konsultimet**

1. Secila palë kontraktuese ose autoriteti i saj kompetent detar mund të kërkojë, në çdo kohë, mbajtjen e konsultimeve me palën tjetër kontraktuese ose autoritetin e saj detar.

2. Konsultimet e kërkuara nga një palë kontraktuese ose nga autoriteti i saj detar duhet të fillojnë brenda një periudhe, që nuk kalon nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së një kërkesë të tillë.

Neni 16  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast mosmarrëveshesh midis palëve kontraktuese lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese do të përpiqen t'i zgjidhin ato me bisedime ndërmjet autoriteteve të tyre detare, mbi bazën e një kërkesë për konsultime.

2. Palët kontraktuese mund të bien dakord për thirrjen e një gjykate arbitrazhi.

Neni 17  
**Regjistrimi**

Menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, bëhet regjistrimi i saj pranë sekretariatit të Kombeve të Bashkuara sipas dispozitave të nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Pala tjetër kontraktuese do të njoftohet për regjistrimin e kryer, duke shënuar numrin e regjistrimit pranë Kombeve të Bashkuara, sapo ky të jetë konfirmuar nga sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

Neni 18  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën, në të cilën palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën se janë përmbushur procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit të fundit.

Neni 19  
**Vlefshmëria, ndryshimi, shfuqizimi**

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar.
  2. Secila palë kontraktuese, pas kërkesës për konsultim, mund të propozojë ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.
  3. Secila palë kontraktuese mund të njoftojë në çdo kohë palën tjetër kontraktuese për vendimin e saj për shfuqizimin e marrëveshjes aktuale. Në këtë rast, marrëveshja do të pushojë së pasuri fuqi gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë nga pala tjetër kontraktuese, përveç rastit kur palët merren vesh për mosshfuqizimin e marrëveshjes përpara skadimit të afatit në fjalë.
- Bërë në Berlin ..... më datë 17 qershor 2010, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, gjermanisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha teksteve autentike. Në rast mosmarrëveshesh në interpretimin e teksteve në gjuhën shqipe dhe gjermane, përcaktues do të jetë teksti në gjuhën angleze.

**LIGJ**  
**Nr.10 397, datë 17.3.2011**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR LIGJIN E ZBATUESHËM PËR DETYRIMET USHQIMORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”, bërë në Hagë më 2 tetor 1973.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6959, datë 4.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**KONVENTA**  
**MBI LIGJIN E ZBATUESHËM PËR DETYRIMET USHQIMORE**  
**(LIDHUR MË 2 TETOR 1973)**

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente,  
*me dëshirën* për të vendosur dispozita të përbashkëta në lidhje me ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj të rriturve;  
*me dëshirën* për të bashkërenduar këto dispozita dhe ato të Konventës së 24 tetorit 1956 mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve;  
kanë vendosur të lidhin këtë Konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

**KAPITULLI I**  
**FUSHA E VEPRIMIT TË KONVENTËS**

Neni 1

Kjo Konventë zbatohet për detyrimet ushqimore që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhje tjetër jogjaku, duke përfshirë edhe një detyrim ushqimor ndaj një të mituri të lindur jashtë martese.

Neni 2

Kjo Konventë rregullon vetëm konfliktet e ligjeve në lidhje me detyrimet ushqimore.  
Vendimet e dhëna në zbatim të kësaj Konvente nuk cenojnë ekzistencën e ndonjë prej marrëdhënieve të referuara në nenin 1.

Neni 3

Ligji i përcaktuar nga kjo Konventë zbatohet pavarësisht nga ndonjë kërkesë reciprociteti dhe pavarësisht nëse ajo është apo jo ligji i një shteti kontraktues.

**KAPITULLI II**  
**LIGJI I ZBATUESHËM**

Neni 4

Ligji i brendshëm i vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor rregullon detyrimet ushqimore të referuara në nenin 1.

Në rast të një ndryshimi të vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor, ligji i brendshëm i vendqëndrimit të ri të zakonshëm zbatohet që nga momenti kur ndodh ndryshimi.

Neni 5

Nëse përfituesi i detyrimit ushqimor nuk është në gjendje, në bazë të ligjit të referuar në nenin 4, për të përfituar detyrimin ushqimor nga ofruesi i këtij detyrimi, zbatohet ligji i shtetësisë së tyre të përbashkët.

Neni 6

Nëse përfituesi i detyrimit ushqimor nuk është në gjendje, në bazë të ligjeve të referuara në nenet 4 dhe 5, për të përfituar detyrimin ushqimor nga ofruesi i këtij detyrimi, zbatohet ligji i brendshëm i autoritetit mbikëqyrës.

#### Neni 7

Në rastin e një detyrimi ushqimor ndërmjet personave me lidhje farefisnore ose me lidhje tjetër jo gjaku, ofruesi i detyrimit ushqimor mund të kundërshtojë një kërkesë nga përfituesi i këtij detyrimi mbi bazën që nuk ka asnjë detyrim të tillë sipas ligjit të shtetësisë së tyre të përbashkët, ose, në mungesë të një shtetësie të përbashkët, sipas ligjit të brendshëm të vendqëndrimit të zakonshëm të ofruesit të detyrimit ushqimor.

#### Neni 8

Pavarësisht nga dispozitat e neneve 4 deri në 6, ligji që zbatohet në një zgjidhje martesë, rregullon, në një shtetet kontraktues në të cilin është dhënë apo njohur zgjidhja e martesës, detyrimet ushqimore ndërmjet bashkëshortëve të ndarë dhe rishikimin e vendimeve në lidhje me këto detyrime.

Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe në rastin e një ndarjeje ligjore dhe në rastin e një martesë, e cila është shpallur e pavlefshme ose është anuluar.

#### Neni 9

E drejta e një organi publik për të marrë rimbursimin e përfitimeve të parashikuara për përfituesin e detyrimit ushqimor rregullohet nga ligji, të cilit i nënshtrohet organi publik.

#### Neni 10

Ligji i zbatueshëm për një detyrim ushqimor përcakton ndër të tjera:

1. nëse, në çfarë mase dhe ndaj kujt një përfitues mund të pretendojë detyrimin ushqimor;
2. cili ka të drejtë të fillojë procedurat në lidhje me detyrimin ushqimor dhe një afat kohor për fillimin e tyre;
3. masën e detyrimit të ofruesit të detyrimit ushqimor, ku një organ publik kërkon rimbursimin e përfitimeve të parashikuara për përfituesin e detyrimit ushqimor.

#### Neni 11

Zbatimi i ligjit të përcaktuar nga kjo Konventë mund të refuzohet vetëm nëse është dukshëm në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Megjithatë, edhe nëse ligji i zbatueshëm e parashikon ndryshe, nevojat e përfituesit të detyrimit ushqimor dhe burimet e ofruesit të këtij detyrimi do të merren parasysh në përcaktimin e shumës së detyrimit ushqimor.

### KAPITULLI III DISPOZITA TË NDRYSHME

#### Neni 12

Kjo Konventë nuk zbatohet për detyrimin ushqimor të pretenduar në një shtet kontraktues që lidhet me periudhën para hyrjes në fuqi të saj në atë shtet.

#### Neni 13

Çdo shtet kontraktues në përputhje me nenin 24, mund të rezervojë të drejtën që të zbatojë këtë Konventë vetëm për detyrimet ushqimore:

1. ndërmjet bashkëshortëve dhe ish-bashkëshortëve;
2. në lidhje me një person që nuk ka arritur moshën e njëzet e një vjeç dhe nuk ka qenë i martuar.

#### Neni 14

Çdo shtet kontraktues, në përputhje me nenin 24, mund të rezervojë të drejtën që të mos zbatojë këtë Konventë për detyrimet ushqimore:

1. ndërmjet personave me lidhje me lidhje farefisnore;
2. ndërmjet personave me lidhje jogjaku;

3. ndërmjet ish-bashkëshortëve ligjërisht të ndarë apo bashkëshortëve, martesë e të cilëve është shpallur e pavlefshme ose është anuluar, nëse vendimi i zgjidhjes së martesës, ndarjes ligjore, pavlefshmërisë apo anulimit është dhënë në mungesë në një shtet, në të cilin pala munguese nuk kishte vendqëndrimin e saj të zakonshëm.

#### Neni 15

Çdo shtet kontraktues, në përputhje me nenin 24, mund të bëjë një rezervë me qëllim që autoritetet e tij të zbatojnë ligjin e tij të brendshëm, nëse përfituesi dhe ofruesi i detyrimit ushqimor janë të dy shtetas të atij shteti dhe nëse ofruesi i detyrimit ushqimor ka atje vendqëndrimin e tij të zakonshëm.

#### Neni 16

Kur ligji i një shteti, që ka për çështjet e detyrimeve ushqimore dy ose më shumë sisteme ligjore të zbatimit territorial apo personal, duhet të marrë në konsideratë - sipas rastit, nëse i është bërë referim ligjit të vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit apo ofruesit të detyrimit ushqimor, ose ligjit të shtetësisë së përbashkët, referimi bëhet në sistemin e përcaktuar nga rregullat në fuqi në atë shtet, ose, nëse, nuk ka rregulla të tilla, në sistemin me të cilin personat e interesuar janë të lidhur më ngushtë.

#### Neni 17

Një shtet kontraktues, brenda të cilit njësi të ndryshme territoriale kanë rregullat e tyre ligjore në çështjet e detyrimeve ushqimore, nuk është i detyruar të zbatojë këtë Konventë për konfliktet e ligjit të lidhura vetëm me njësitë e tij territoriale.

#### Neni 18

Kjo Konventë zëvendëson, në marrëdhëniet midis shteteve që janë palë në të, Konventën mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve, lidhur në Hagë, më 24 tetor 1956.

Megjithatë, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për një shtet që, në bazë të rezervës së parashikuar në nenin 13, ka përjashtuar zbatimin e kësaj Konvente për detyrimet ushqimore në lidhje me një person, i cili nuk ka arritur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk ka qenë i martuar.

#### Neni 19

Kjo Konventë nuk cenon ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar që përmban dispozita për çështje që rregullohen nga kjo Konventë, në të cilën një shtet kontraktues është ose bëhet palë.

## KAPITULLI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 20

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtete që ishin anëtare të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private, në kohën e sesionit të dymbëdhjetë të saj.

Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet dhe instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

### Neni 21

Çdo shtet që është bërë anëtar i Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private pas datës së sesionit të dymbëdhjetë të saj, ose që është anëtar i Kombeve të Bashkuara apo i një agjencie të specializuar të kësaj organizate, ose palë në Statusin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mund të aderojë në këtë Konventë, pasi ajo ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 25.

Instrumenti i pranimit depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

### Neni 22

Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë që kjo Konventë shtrin veprimin në të gjitha territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të cilave ai është përgjegjës, ose në një ose më shumë prej tyre. Një deklaratë e tillë do të ketë efekt, në datën e hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin në fjalë.

Në çdo kohë pas kësaj, këto shtrirje të veprimit të Konventës njoftohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

### Neni 23

Një shtet kontraktues që ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në çështjet e detyrimit ushqimor, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, deklaron se kjo Konventë shtrin veprimin në të gjitha njësitë e tij territoriale apo vetëm në një ose më shumë prej tyre, dhe mund të ndryshojë deklaratën e tij, duke paraqitur një deklaratë tjetër, në çdo kohë pas kësaj.

Këto deklarata i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës dhe deklarojnë shprehimisht njësinë territoriale në të cilën zbatohet Konventa.

### Neni 24

Çdo shtet mund të bëjë, jo më vonë se momenti i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një ose më shumë rezerva të përmendura në nenet 13 deri në 15. Asnjë rezervë tjetër nuk lejohet.

Çdo shtet mund të bëjë gjithashtu, kur njofton shtrirjen e veprimit të Konventës në përputhje me nenin 22, një ose më shumë nga rezervat në fjalë të zbatueshme për të gjitha ose për disa nga territoret e përmendura në shtrirjen e veprimit të Konventës.

Çdo shtet kontraktues mund të tërheqë, në çdo kohë, një rezervë që ka bërë. Një tërheqje e tillë njoftohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

Një rezervë e tillë pushon së pasuri efekt në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit të referuar në paragrafin e mësipërm.

## Neni 25

Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose të miratimit të referuar në nenin 20.

Pas kësaj, Konventa hyn në fuqi:

- për çdo shtet që e ratifikon, pranon ose miraton atë më pas, në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit;
- për çdo shtet që aderon, në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tij të aderimit;
- për territorin në të cilin Konventa ka shtrirë veprimin në përputhje me nenin 22, në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit të referuar në atë nen.

## Neni 26

Kjo Konventë mbetet në fuqi për pesë vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 25, edhe për shtetet që e kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të më pas.

Nëse nuk ka pasur denoncim, kjo Konventë rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të periudhës pesëvjeçare. Ai mund të kufizohet në disa nga territoret në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm për sa i përket shtetit, i cili e ka njoftuar atë. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

## Neni 27

Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës njofton shtetet anëtare të Konferencës dhe shtetet që kanë aderuar në përputhje me nenin 21, për sa më poshtë:

1. nënshkrimet dhe ratifikimet, pranimet dhe miratimet e referuara në nenin 20;
2. datën në të cilën kjo konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 25;
3. aderimet e referuara në nenin 21 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
4. shtrirjet e veprimit të referuara në nenin 22 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
5. deklaratat e referuara në nenin 23, si dhe ndryshimet e tyre dhe datat në të cilat këto deklarata dhe ndryshimet e tyre hyjnë në fuqi;
6. denoncimet e referuara në nenin 26;
7. rezervat e referuara në nenet 13 deri në 15 dhe 24, dhe tërheqjet e rezervave të referuara në nenin 24.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë, në datën 2 tetor 1973, në gjuhën angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëllorj të barasvlershme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Holandës, dhe nga të cilat një kopje e vërtetuar i dërgohet, nëpërmjet rrugëve diplomatike, secilit prej shteteve anëtare të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private në datën e sesionit të dymbëdhjetë të saj.

**LIGJ**  
**Nr.10 398, datë 17.3.2011**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR NJOHJEN  
DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE NË LIDHJE ME DETYRIMET USHQIMORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”, bërë në Hagë më 2 tetor 1973.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6960, datë 4.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**KONVENTA**  
**MBI NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE NË LIDHJE ME**  
**DETYRIMET USHQIMORE**  
*(e lidhur më 2 tetor 1973)*

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente,  
*me dëshirën* për të vendosur dispozita të përbashkëta për të rregulluar njohjen e ndërsjellë dhe zbatimin e vendimeve që lidhen me detyrimet ushqimore për sa i përket të rriturve,  
*me dëshirën* për të bashkërenduar këto dispozita dhe ato të Konventës së 15 prillit 1958 mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve,  
kanë vendosur të lidhin një Konventë për këtë qëllim dhe të bien dakord për dispozitat e mëposhtme.

**KAPITULLI I**  
**FUSHA E VEPRIMIT TË KONVENTËS**

Neni 1

Kjo Konventë zbatohet për një vendim të dhënë nga një autoritet gjyqësor apo administrativ në një shtet kontraktues në lidhje me një detyrim ushqimor që rrjedh nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhjeje tjetër jo gjaku, duke përfshirë një detyrim ushqimor ndaj një të mituri, të lindur jashtë martese ndërmjet:

1. një përfituesi të detyrimit ushqimor dhe një ofruesi të detyrimit ushqimor; apo
2. një ofruesi të detyrimit ushqimor dhe një autoriteti publik, i cili pretendon rimbursimin e fitimeve të dhëna një përfituesi të detyrimit ushqimor.

Konventa zbatohet, gjithashtu, për një marrëveshje të bërë nga ose para një autoriteti të tillë (veprimi), në lidhje me detyrimet e lartpërmendura dhe ndërmjet palëve të njëjta (në vijim e referuar si “marrëveshje”).

#### Neni 2

Kjo Konventë zbatohet për një vendim ose marrëveshje, sidoqoftë të cilësuar.

Konventa zbatohet, gjithashtu, për një vendim ose marrëveshje që ndryshon një vendim ose marrëveshje të mëparshme, edhe në rastin kur kjo rrjedh nga një shtet jokontraktues.

Konventa zbatohet pavarësisht nga karakteri ndërkombëtar ose i brendshëm i pretendimit për detyrim ushqimor dhe nga shtetësia apo vendqëndrimi i zakonshëm i palëve.

#### Neni 3

Nëse një vendim ose marrëveshje nuk lidhet vetëm me një detyrim ushqimor, efekti i Konventës kufizohet në pjesët e vendimit apo marrëveshjet që lidhen me detyrimet ushqimore.

### KAPITULLI II KUSHTET PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE

#### Neni 4

Një vendim i dhënë në një shtet kontraktues njihet apo zbatohet në një shtet tjetër kontraktues:

1. nëse ai është dhënë nga një autoritet që konsiderohet të ketë juridiksion në bazë të nenit 7 ose 8; dhe

2. nëse ai nuk u nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës.

Vendimet që zbatohen në mënyrë të përkohshme dhe masat e përkohshme, megjithëse u nënshtrohen formave të zakonshme të rishikimit, njihen apo zbatohen në shtetin, të cilit i drejtohet kërkesa nëse vendime të ngjashme mund të jenë dhënë dhe zbatuar në atë shtet.

#### Neni 5

Megjithatë, njohja apo zbatimi i një vendimi mund të refuzohet:

1. nëse njohja ose zbatimi i vendimit është haptazi në kundërshtim me politikën publike (*rendin publik*) të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa; ose

2. nëse vendimi është marrë me mashtrim, që lidhet me një çështje procedurale; ose

3. nëse procedimet ndërmjet palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim nuk kanë përfunduar ende para një autoriteti të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa dhe ato procedime kanë filluar më parë; ose

4. nëse vendimi është i papajtueshëm me një vendim të dhënë ndërmjet palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim, ose në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa ose në një shtet tjetër, me kusht që ky vendim i fundit të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen dhe zbatimin e tij në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa.

#### Neni 6

Pa cenuar dispozitat e nenit 5, një vendim i dhënë në mungesë njihet ose zbatohet vetëm nëse njoftimi i fillimit të procedimit, duke përfshirë njoftimin për thelbin e pretendimit, i është njoftuar palës munguese në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës dhe nëse, duke pasur parasysh rrethanat, ajo palë ka pasur kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar atij pjesëmarrjen në procedim.

#### Neni 7

Një autoritet në shtetin e origjinës konsiderohet se ka juridiksion për qëllimet e kësaj Konvente:

1. nëse ofruesi i detyrimit ushqimor ose përfituesi i detyrimit ushqimor ka pasur vendqëndrimin e tij të zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur ka filluar procedimi; ose
2. nëse ofruesi i detyrimit ushqimor dhe përfituesi i detyrimit ushqimor ishin shtetas të shtetit të origjinës në kohën kur ka filluar procedimi; ose
3. nëse i padituri kishte paraqitur në juridiksionin e autoritetit, ose shprehimisht, ose duke u mbrojtur në bazë të themelit të çështjes, pa kundërshtuar juridiksionin.

#### Neni 8

Pa cenuar dispozitat e nenit 7, autoriteti i një shteti kontraktues që ka dhënë vendim ndaj një pretendimi për detyrim ushqimor, konsiderohet se ka juridiksion për qëllimet e kësaj Konvente, nëse detyrimi ushqimor rrjedh për arsye të një zgjidhjeje martesë ose ndarjeje ligjore, ose të një deklaratë që një martesë është e pavlefshme ose e anuluar, të marrë nga autoriteti i atij shteti që njihet se ka juridiksion në këtë çështje sipas ligjit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

#### Neni 9

Autoriteti i shtetit, të cilit i drejtohet kërkesa, është i detyruar nga faktet e provuara mbi të cilat autoriteti i shtetit të origjinës ka bazuar juridiksionin e tij.

#### Neni 10

Nëse një vendim trajton disa çështje në një kërkesë për detyrim ushqimor dhe nëse njohja apo zbatimi nuk mund të ofrohet për të gjithë vendimin, autoriteti i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa zbaton këtë Konventë në atë pjesë të vendimit që mund të njihet apo zbatohet.

#### Neni 11

Nëse një vendim parashikon pagesën periodike të detyrimit ushqimor, zbatimi ofrohet në lidhje me pagesat tashmë të kërkueshme dhe në lidhje me pagesat e ardhshme.

#### Neni 12

Nuk ka rishikim nga ana e autoritetit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, të themelit të një vendimi, nëse kjo Konventë nuk parashikon ndryshe.

### KAPITULLI III PROCEDURA PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE

#### Neni 13

Procedura për njohjen apo zbatimin e një vendimi rregullohet nga ligji i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, në rast se kjo Konventë nuk parashikon ndryshe.

#### Neni 14

Njohja apo zbatimi i pjesshëm i një vendimi mund të zbatohet në çdo rast.



## Neni 15

Një përfitues i detyrimit ushqimor, i cili në shtetin e origjinës ka përfituar nga ndihma e plotë apo e pjesshme ligjore ose nga përjashtimi nga kostot apo shpenzimet, ka të drejtën në çdo proces për njohjen apo zbatimin, për të përfituar nga ndihma më e favorshme ligjore ose nga përjashtimi më i gjerë i mundshëm nga kostot apo shpenzimet e parashikuara nga ligji i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

## Neni 16

Asnjë garanci, obligacion apo depozitë, sidoqoftë e cilësuar, nuk kërkohet për të garantuar pagesën e kostove dhe shpenzimeve në proceset të cilave i referohet Konventa.

## Neni 17

Pala që kërkon njohjen apo zbatimin e një vendimi paraqet:

1. një kopje të plotë dhe të vërtetuar të vendimit;
2. çdo dokument të nevojshëm për të vërtetuar se vendimi nuk i nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës dhe, kur është e nevojshme, që është i zbatueshëm;
3. nëse vendimi është dhënë në mungesë, një kopje origjinale ose të vërtetuar të çdo dokumenti të kërkuar për të vërtetuar se njoftimi i fillimit të procesit, duke përfshirë njoftimin për thelbin e pretendimit, i është njoftuar siç duhet palës munguese, në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës;
4. sipas rastit, çdo dokument të nevojshëm për të provuar se ai ka përfituar ndihmë juridike ose përjashtim nga kostot ose shpenzimet në shtetin e origjinës;
5. një përkthim të vërtetuar të dokumenteve të mësipërme, nëse autoriteti i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa nuk e kërkon një përkthim të tillë.

Nëse nuk arrihet të përgatiten dokumentet e lartpërmendura ose nëse përmbajtja e vendimit nuk e lejon autoritetin e shtetit të cilit i drejtohet kërkesa për të verifikuar nëse janë plotësuar kushtet e kësaj Konvente, autoriteti do të lejojë një periudhë të caktuar kohore për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme.

Nuk mund të kërkohet asnjë legalizim apo formalitet tjetër.

## KAPITULLI IV DISPOZITA SHITESË NË LIDHJE ME AUTORITETET PUBLIKE

## Neni 18

Një vendim i dhënë kundër një ofruesi të detyrimit ushqimor, mbi kërkesën e një autoriteti publik, i cili pretendon rimbursimin e fitimeve të parashikuara për përfituesin të një detyrimi ushqimor, njihet dhe zbatohet në përputhje me këtë Konventë:

1. nëse rimbursimi mund të përfitohet nga autoriteti publik sipas ligjit të cilit ai i nënshtrohet; dhe
2. nëse ekzistenca e një detyrimi ushqimor ndërmjet përfituesit dhe ofruesit të detyrimit ushqimor është parashikuar nga ligji i brendshëm i zbatueshëm sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

## Neni 19

Një autoritet publik mund të kërkojë njohjen apo zbatimin e një vendimi të dhënë ndërmjet një përfituesi të detyrimit ushqimor dhe ofruesi të detyrimit ushqimor në masën e fitimeve të parashikuara për përfituesin, nëse atij i është dhënë e drejta *ipso jure* sipas ligjit të cilit ai i

nënshtrohet, për të kërkuar njohjen apo zbatimin e vendimit në vend të përfituesit të detyrimit ushqimor.

#### Neni 20

Pa cenuar dispozitat e nenit 17, autoriteti publik që kërkon njohjen apo zbatimin e një vendimi paraqet çdo dokument të nevojshëm për të provuar se plotëson kushtet e nënparagrafit 1 të nenit 18 apo nenit 19, dhe që fitimet janë parashikuar për përfituesin e detyrimit ushqimor.

### KAPITULLI V MARRËVESHJET

#### Neni 21

Një marrëveshje që është e detyrueshme në shtetin e origjinës, njihet dhe zbatohet duke iu nënshtuar të njëjtave kushte si të një vendimi, në masën që këto kushte janë të zbatueshme për të.

### KAPITULLI VI DISPOZITA TË NDRYSHME

#### Neni 22

Një shtet kontraktues, sipas ligjit të të cilit transferimi i fondeve është i kufizuar, i jep prioritetin më të lartë transferimit të fondeve që paguhen si detyrim ushqimor apo për të mbuluar kostot dhe shpenzimet në lidhje me çdo kërkesë sipas kësaj Konvente.

#### Neni 23

Kjo Konventë nuk kufizon zbatimin e një instrumenti ndërkombëtar në fuqi ndërmjet shtetit të origjinës dhe shtetit të cilit i drejtohet kërkesa apo ndonjë ligji tjetër të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa për qëllimet e përfitimit të njohjes apo zbatimit të një vendimi apo marrëveshjeje.

#### Neni 24

Kjo Konventë zbatohet pavarësisht nga data në të cilën është dhënë vendimi.

Kur një vendim është dhënë para hyrjes në fuqi të Konventës ndërmjet shtetit të origjinës dhe shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, ai zbatohet në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa vetëm për pagesat që duhet të paguhen pas hyrjes së saj në fuqi.

#### Neni 25

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë në çdo kohë se dispozitat e kësaj Konvente shtrihen, në lidhje me shtetet e tjera që bëjnë një deklaratë në bazë të këtij neni, në një akt zyrtar (*acte authentique*) të hartuar nga ose para një autoriteti ose zyrtari publik dhe drejtpërdrejt të zbatueshme në shtetin e origjinës në masën që këto dispozita mund të zbatohen për këto akte.

#### Neni 26

Çdo shtet kontraktues, në përputhje me nenin 34, mund të rezervojë të drejtën për të mos njohur ose zbatuar:

1. një vendim ose marrëveshje në masën që kjo lidhet me një periudhë kohore pasi përfituesi i detyrimit ushqimor arrin moshën 21 vjeç ose martohet, përveç rasteve kur përfituesi është ose ka qenë bashkëshorti i ofruesit të detyrimit ushqimor;

2. një vendim ose marrëveshje në lidhje me detyrimet ushqimore:

a) ndërmjet personave me lidhje farefisnore;

b) ndërmjet personave me lidhje jogjaku;

3) një vendim ose marrëveshje, nëse nuk parashikon pagesa periodike të detyrimit ushqimor.

Një shtet kontraktues që ka bërë një rezervë nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e kësaj Konvente për vendime ose marrëveshje të tilla që përjashtohen nga rezerva e tij.

#### Neni 27

Nëse një shtet kontraktues ka, në çështjet e detyrimeve ushqimore, dy ose më shumë sisteme ligjore të zbatueshme për kategori të ndryshme personash, çdo referencë në ligjin e atij shteti interpretohet si referencë në sistemin ligjor që përcakton të zbatueshëm ligji i tij për një kategori të veçantë personash.

#### Neni 28

Nëse një shtet kontraktues ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të detyrimit ushqimor:

1. çdo referim në ligjin, procedurën apo autoritetin e shtetit të origjinës interpretohet si referim në ligjin, procedurën apo autoritetin e njësisë territoriale në të cilën është dhënë vendimi;

2. çdo referim në ligjin, procedurën apo autoritetin e shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, interpretohet si referim në ligjin, procedurën apo autoritetin e njësisë territoriale në të cilën është kërkuar njohja apo zbatimi;

3. çdo referim i bërë në zbatim të nënparagrafit 1 ose 2 në ligjin apo procedurën e shtetit të origjinës ose në ligjin apo procedurën e shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, interpretohet se përfshin çdo rregull dhe parim përkatës ligjor të shtetit kontraktues që zbatohet në njësitë territoriale që përfshihen në të;

4. çdo referim në vendqëndrimin e zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor në shtetin e origjinës, interpretohet si referim në vendqëndrimin e tij të zakonshëm në njësinë territoriale në të cilën është dhënë vendimi.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë në çdo kohë se nuk do të zbatojë ndonjë ose më shumë nga rregullat e mësipërme për një ose më shumë prej dispozitave të kësaj Konvente.

#### Neni 29

Kjo Konventë zëvendëson, për sa u përket shteteve që janë palë në të, Konventën mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve, e lidhur në Hagë më 15 prill 1958.

### KAPITULLI VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 30

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet që ishin anëtare të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private në kohën e sesionit të dymbëdhjetë të saj.

Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet, dhe instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

#### Neni 31

Çdo shtet që është bërë anëtar i Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private pas datës së sesionit të dymbëdhjetë të saj, ose që është anëtar i Kombeve të Bashkuara ose i një agjencie të specializuar të kësaj organizate, ose palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mund të aderojë në këtë Konventë pasi ajo të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 35.

Instrumenti i aderimit depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës.

Ky aderim ka efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit aderues dhe atyre shteteve kontraktuese, të cilat nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për aderimin e tij, brenda dymbëdhjetë muajve pas marrjes së njoftimit të përmendur në nënparagrafin 3 të nenit 37. Ky kundërshtim mund të paraqitet, gjithashtu, nga shtetet anëtare në kohën kur ato ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë Konventën pas aderimit. Çdo kundërshtim i tillë i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

#### Neni 32

Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë që kjo Konventë shtrin veprimin në të gjitha territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës, ose në një ose më shumë prej tyre. Kjo deklaratë hyn në fuqi datën e hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin në fjalë.

Në çdo kohë pas kësaj, këto shtrirje të veprimit të Konventës i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Shtrirja ka efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shteteve kontraktuese, të cilat nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për shtrirjen e veprimit të Konventës gjatë periudhës prej dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit të përmendur në nënparagrafin 4 të nenit 37 dhe territorin apo territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave shteti në fjalë është përgjegjës dhe në lidhje me të cilat është bërë njoftimi.

Një kundërshtim i tillë mund të paraqitet edhe nga shtetet anëtare në kohën kur ato ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë Konventën pas shtrirjes së veprimit të saj.

Çdo kundërshtim i tillë i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

#### Neni 33

Nëse një shtet kontraktues ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të detyrimit ushqimor, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose aderimit, ai mund të deklarojë se kjo Konventë shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre, dhe mund të ndryshojë deklaratën e tij duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë pas kësaj.

Këto deklarata i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës dhe deklarojnë shprehimisht njësinë territoriale në të cilën zbatohet Konventa.

Shtetet e tjera kontraktuese mund të refuzojnë të njohin një vendim për detyrimin ushqimor nëse në datën kur është kërkuar njohja, Konventa nuk është e zbatueshme në njësinë territoriale në të cilën ishte dhënë vendimi.

#### Neni 34

Jo më vonë se në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, çdo shtet mund të bëjë një ose më shumë nga rezervat e përmendura në nenin 26. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër.

Në njoftimin e një shtrirjeje të veprimit të Konventës në përputhje me nenin 32, çdo shtet, gjithashtu, mund të bëjë një ose më shumë nga rezervat e lartpërmendura të zbatueshme për të gjithë ose disa nga territoret e përmendura në shtrirjen e veprimit të Konventës.

Çdo shtet kontraktues mund të tërheqë në çdo kohë rezervën që ka bërë. Një tërheqje e tillë i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Kjo rezervë pushon së pasuri efekt ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

#### Neni 35

Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit të përmendur në nenin 30.

Më pas, Konventa hyn në fuqi:

- për çdo shtet që e ratifikon, pranon ose miraton atë më pas, në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit;

- për çdo shtet aderues, në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas përfundimit të periudhës së përmendur në nenin 31;

- për territorin në të cilin Konventa është shtrirë në përputhje me nenin 32, në ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas përfundimit të periudhës së përmendur në atë nen.

#### Neni 36

Konventa mbetet në fuqi për pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 35, edhe për shtetet që e kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të më pas.

Nëse nuk ka pasur denoncim, kjo Konventë do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të periudhës pesëvjeçare.

Ai mund të kufizohet në disa nga territoret për të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm për sa i përket shtetit që e ka njoftuar atë. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

#### Neni 37

Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës njofton shtetet anëtare të Konferencës dhe shtetet që kanë aderuar në përputhje me nenin 31, për sa më poshtë:

1. nënshkrimet dhe ratifikimet, pranimet dhe miratimet e përmendura në nenin 30;
2. datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 35;
3. aderimet e përmendura në nenin 31 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
4. shtrirjet e veprimit të Konventës të përmendura në nenin 32 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
5. kundërshtimet e ngritura për aderimet dhe shtrirjet e veprimit të Konventës, të përmendura në nenet 31 dhe 32;

6. deklaratat e përmendura në nenet 25 dhe 32;

7. denoncimet e përmendura në nenin 36;

8. rezervat e përmendura në nenet 26 dhe 34 dhe tërheqjet e përmendura në nenin 34.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë në datën 2 tetor 1973, në gjuhën angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëllorj të barasvlershme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e qeverisë së Holandës, dhe nga të cilat një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet rrugëve diplomatike secilit prej shteteve anëtare të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private në datën e sesionit të dymbëdhjetë të saj.

**LIGJ**  
**Nr.10 399, datë 17.3.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005**  
**“PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Ndhmë ekonomike” është mbështetja, në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. “Përfitime në natyrë” është mbështetja në mallra ushqimore dhe të përdorimit të përditshëm e në veshmbathje, që u jepen familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.”.

c) Në pikën 7, fjalët “shpërndarjen e ndihmës ekonomike” zëvendësohen me fjalët “dokumentacionin e aplikantëve për përfitimimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar”.

ç) Në fjalinë e dytë të pikës 13, pas fjalës “fizike” shtohen fjalët “të verbrit”.

d) Pas pikës 23 shtohen pikat 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31 me këtë përmbajtje:

“24. “Paraplegjik” është çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme.

25. “Tetraplegjik” është çdo person që vuan nga paraliza e katër anësive.

26. “Fëmijë” është fëmija, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

27. “Person mbi moshë pune” është personi fizik që, në çastin e vlerësimit të kriterëve për përfitimimin e ndihmës ekonomike, është mbi moshën e përcaktuar për atë vit, për të drejtën e pensionit, sipas nenit 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

28. “Individ në nevojë” është personi fizik që është: jetim, viktimë e trafikimit, viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare.

29. “Viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare” është çdo person, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 4 të nenit 3 të ligjit nr. 9969, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtjeje ose urdhër mbrojtjeje i menjëhershëm, me vendim të gjykatës.

30. “Punë dhe shërbime” janë punët apo shërbimet, që ofrohen nga organet e qeverisjes vendore në komunitet, apo punët dhe shërbimet, që ofrohen nga programe dhe projekte të organizuara nga institucione e struktura të qeverisjes qendrore.

31. “Kujdestar me pagesë” është personi i caktuar për t’u kujdesur për personin me aftësi të kufizuara, që ofron shërbim për të në veprimtarinë e përditshme, në shtëpi, në udhëtim, në punë, në shkollë dhe në veprimtaritë shoqërore.”.

## Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 5

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë.
2. Jetimët, të cilët nuk janë në institucione.
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.
4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.
5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.”.

## Neni 3

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 10

1. Ndihma ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë dhe e kushtëzuar, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji. Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike vlerësohen sipas nevojave dhe mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive dhe transparente, si pjesë e një formule të pikëzuar. Kriteret, detajet e formulës dhe procedurat për përcaktimin e përfitimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Familjet dhe individët në nevojë kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kushtëzimi i ndihmës ekonomike bëhet:

a) kur personi në moshë pune, anëtar i familjes në nevojë, nuk merr pjesë në punë apo shërbime;

b) në raste të tjera të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Fëmijët e familjes në nevojë, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe jetimët që nuk janë në institucione që ndjekin arsimin e detyrueshëm, sipas ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, marrin një pagesë shtesë, deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

6. Masa mujore e ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes, procedurat dhe dokumentacioni, kohëzgjatja e kriteret që duhet të plotësojnë familjet dhe individët në nevojë për kushtëzimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe mënyra e përlllogaritjes së kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore nxjerr udhëzim për mënyrën e përlllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike.”.

#### Neni 4

Në nenin 15, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 e 5 me këtë përmbajtje:

“3. Procedura e evidentimit të familjes kujdestare organizohet dhe mbikëqyret nga strukturat e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore të organeve të qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin e rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare përcaktohen në rregulloren e miratuar nga organet e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8652, datë 30.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

4. Kriteret, dokumentacioni dhe procedura që do të ndiqet nga strukturat e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore të organeve të qeverisjes vendore, për evidentimin e familjeve kujdestare, si dhe masa e financimit për shpenzimet e fëmijës të vendosur në familje kujdestare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimeve.”.

#### Neni 5

Në nenin 19, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Përfshihen nga llogaritja e të ardhurave, sipas pikës 3 të këtij neni, familjet në nevojë kur:

a) nuk kanë kryefamiljarë, për arsye të vdekjes së të dy prindërve, të cilët kanë pasur fëmijët në ngarkim;

b) njëri prej prindërve është duke vuajtur dënimin me burgim, për vepra penale, me vendim gjykate të formës së prerë, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, të cilët kanë pasur fëmijët në ngarkim;

c) njërit prind i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, në gjendjen familjare të të cilit ka fëmijë;

ç) kanë si kryefamiljar një person me aftësi të kufizuara, fizike e mendore, i verbër, paraplegjik/tetraplegjik ose invalid pune, dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;

d) kanë si kryefamiljar nënën, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, si dhe kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;

dh) kanë si kryefamiljar një pjesëtar të familjes që është mbi moshë pune dhe, kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë dhe persona mbi moshë pune, pavarësisht nga të ardhurat, nga pensioni apo toka;

e) janë familje të mbyllura në shtëpi, si pasojë e gjakmarrjes;

ë) janë familje që i përkasin minoritetit rom;

f) janë familje nën nivelin e varfërisë, sipas listës së përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse.

5. Këshilli i Ministrave, kur e sheh të nevojshme, parashikon edhe raste të tjera të përjashtimit nga llogaritja e të ardhurave, përveç atyre të parashikuara në pikën 4 të këtij neni.”.

#### Neni 6

Në nenin 20 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga:

a) kryetari i familjes;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykate të formës së prerë.



Kërkesa nënshkruhet edhe nga të gjithë anëtarët madhorë të saj, duke deklaruar edhe personin madhor që do të administrojë paratë. Aplikantët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori shoqëror pranë njësisë së qeverisjes vendore.”.

b) Fjalja e dytë e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të kujdestarëve të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

c) Në fjalinë e dytë të pikës 4, pas fjalës “Kriteret” shtohen fjalët “procedurat dhe dokumentacioni.”.

#### Neni 7

Në nenin 21, pas fjalëve “me fondet e buxhetit vendor” shtohen fjalët “dhe deri në 3 për qind të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.”.

#### Neni 8

Në nenin 26 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b” të pikës 5, fjala “hartimin” zëvendësohet me fjalën “monitorimin”.

b) Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) ngre dhe administron regjistrin elektronik kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkuqjesit shoqëror.”.

#### Neni 9

Në nenin 27 pika 4, fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Përmbajtja, që do të kenë informacionet dhe raportet e njësisë së qeverisjes vendore, treguesit statistikore, që do të mblidhen, periodiciteti i mbledhjes së tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 10

Neni 26 i ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhet neni 27, ndërsa neni 27 i po këtij ligji bëhet neni 26.

#### Neni 11

Në nenin 29 pika 7 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Masa e përfitimit të ndihmës ekonomike, për familjen e vendosur sipas paragrafit të parë të kësaj pike, caktohet e ndarë për të dy bashkëshortët, të cilët janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk kanë ende një vendim të formës së prerë për këtë çështje.”.

#### Neni 12

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta programon fondet për bllok-ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe detajon që në fillim të vitit për çdo njësi të qeverisjes vendore.

Kriteret dhe treguesit, që përdoren për programimin e bllok-ndihmës, përcaktohen në bazë të treguesve të vlerësimit të varfërisë dhe rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 13

Në nenin 36 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në paragrafin e parë, fjalët “delegon një herë në katër muaj” zëvendësohen me fjalën “transferon”.
- b) Paragrafi i dytë shfuqizohet.

#### Neni 14

Në nenin 38, në rreshtin e parë të paragrafit të parë fjala “delegohen” zëvendësohet me fjalën “transferohen”.

#### Neni 15

Në fund të nenit 40 shtohen fjalët “dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë””.

#### Neni 16

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 41

1. Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 31 e 42/1 të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë veprë penale:

- a) përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- b) ndëshkohen me masë disiplinore.

2. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 31 e 42/1 të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, konstaton kundërvajtjen administrative dhe i propozon, për shkelësit, kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore/Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror vendosjen e:

- a) gjobës nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë;
- b) masës disiplinore;
- c) shpërblimin e dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë.

3. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat e ngarkuar për zbatim, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente për shkelësit e ligjit.

4. Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen dhe përdoren për ndihmën ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar e shërbimet e përkujdesit shoqëror, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 71 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.”.

#### Neni 17

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 42

1. Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike, sipas një formule të pikëzuar, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe përdorimi i regjistrit elektronik kombëtar të të dhënave për aplikuesit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, do të pilotohen për një periudhë dyvjeçare në njësitë e qeverisjes vendore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, pas përcaktimit të formulës së pikëzimit dhe ngritjes së regjistrit elektronik kombëtar.

2. Për njësitë e qeverisjes vendore, në të cilat nuk do të pilotohet formula e pikëzuar, do të zbatohen kriteret e përfitimit, kriteret e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike, procedura, dokumentacioni dhe mënyra e përlogaritjes së përfitimit të ndihmës ekonomike, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 6 të nenit 10 të këtij ligji.”.

#### Neni 18

Pas nenit 42 shtohen nenet 42/1 dhe 42/2 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 42/1

Në njësitë e qeverisjes vendore, në të cilat do të kryhet pilotimi i regjistrit elektronik kombëtar, zbatohet procedura si më poshtë:

1. Kërkesa për të përfituar ndihmën ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes/individët në nevojë dhe firmoset nga të gjithë anëtarët madhorë të saj, duke deklaruar edhe personin madhor që do të administrojë paratë. Aplikantët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori shoqëror, pranë njësisë së qeverisjes vendore, i cili hedh në regjistrin elektronik kombëtar të dhënat e paraqitura me dokumentacion.

2. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar paraqiten tek administratori shoqëror, pranë njësisë së qeverisjes vendore, i cili hedh në regjistrin kombëtar elektronik të dhënat e paraqitura me dokumentacion.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror paraqiten tek administratori shoqëror, pranë njësisë së qeverisjes vendore, i cili hedh në regjistrin kombëtar elektronik të dhënat e paraqitura me dokumentacion.

4. Administratori shoqëror, pas hedhjes të së dhënave, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ka për detyrë:

a) të identifikojë familjet/individët që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar;

b) të verifikojë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të familjeve/individëve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) të propozojë në këshillin e bashkisë/komunës familjet/individët në nevojë, për të përfituar ndihmë ekonomike;

ç) të llogarisë dhe të përcaktojë masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja;

d) të ndihmojë në përgatitjen e dokumentacionit personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar;

dh) të marrë pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin që familja/individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe të listës së personave me aftësi të kufizuara;

e) të vlerësojë nevojat e individëve ose familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore, në përputhje me përparësitë vendore, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, të përgatisin dokumentacionin e propozimet në këshillin e bashkisë ose komunës;

ë) të regjistrojë vendimin e këshillit të bashkisë/komunës për individët, kur shërbimi i përkujdesit shoqëror ofrohet në njësinë e qeverisjes vendore.

5. Administratori shoqëror paraqet në këshillin e bashkisë/komunës projektvendimin për propozimin për:

a) familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit për këto familje/individë në nevojë;

b) listën e personave me aftësi të kufizuara;

c) individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, të cilat ofrohen në njësinë e qeverisjes vendore;

ç) individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, të cilat nuk ofrohen në njësinë e qeverisjes vendore, për të cilët bëhen vlerësime për t'u ofruar shërbime jashtë juridiksionit të njësisë së qeverisjes vendore.

6. Këshilli i bashkisë/komunës merr vendimin për propozimin që:

a) familja/individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit për këto familje/individë në nevojë;

b) listën e personave me aftësitë kufizuara;

c) individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, të cilat nuk ofrohen në njësinë e qeverisjes vendore, për të cilët bëhen vlerësime për t'u ofruar shërbime jashtë juridiksionit të njësisë së qeverisjes vendore.

7. Këshilli i bashkisë/komunës merr vendim për ofrimin e shërbimit për individët, kur shërbimi i përkujdesit shoqëror ofrohet në njësinë e qeverisjes vendore.

8. Vendimi i këshillit të bashkisë/komunës, sipas pikës 5 të këtij neni, i përcillet menjëherë zyrtarisht drejtorisë rajonale të shërbimeve sociale shtetërore, së bashku me dokumentacionin shoqëruar, për personat me aftësi të kufizuara.

9. Drejtoria rajonale e shërbimeve sociale shtetërore verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror në regjistrin kombëtar elektronik të të dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse për:

a) familjet/individët në nevojë, të cilët janë propozuar me vendim të këshillit të bashkisë/komunës që të trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë propozuar me vendim të këshillit të bashkisë/komunës;

c) individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, të cilat nuk ofrohen në njësinë e qeverisjes vendore.

10. Drejtoria rajonale e shërbimeve sociale shtetërore, pas verifikimit të të dhënave, sipas pikës 9 të këtij neni, merr vendim për:

a) caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfutues të ndihmës ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe masën e përfitimit të tyre;

b) refuzimin e kërkesës për caktimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për familjet/individët në nevojë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) përcjelljen e dosjes për vlerësim në KMCAP, për personat me aftësi të kufizuara;

ç) dërgimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, për caktimin e ofruesit të shërbimit, për individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, kur ky shërbim nuk ofrohet në njësinë e qeverisjes vendore.

11. Për rastet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 10 të këtij neni, i dërgohet kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore vendimi:

a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

b) për të kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfutuesit e ndihmës ekonomike.

12. Drejtoria rajonale e shërbimeve sociale shtetërore për kërkuesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, pas marrjes së vendimit nga KMCAP-ja, merr vendim për caktimin e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe ia dërgon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse për kryerjen e veprimeve financiare për kryerjen e pagesës, së bashku me dokumentacionin shoqëruar.

## Neni 42/2

Në njësitë e qeverisjes vendore, në të cilat do të kryhet pilotimi, sipas pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji, nuk do të zbatohen pikat 1 dhe 2 të nenit 29 të këtij ligji.”.

## Neni 19

Në nenin 43 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë, pas fjalëve “nenit 11” shtohen fjalët “nenit 15 pika 4” dhe pas fjalëve “nenit 20” shtohen fjalët “nenit 22 pika 1”.

b) Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore të nxjerrë udhëzime në zbatim të neneve 10 pika 7 dhe 15 pika 5.”.

## Neni 20

Kudo në ligj, ku është përdorur emërtimi “ministri/Ministria e Punës, Çështjeve Sociale/MPÇS” zëvendësohet me emërtimin “ministri/ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.”.

## Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6961, datë 4.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

## **UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr.4196/1, datë 17.3.2011**

### **PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 12.2.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT, PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” dhe të paragrafit të parë të nenit 47 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2009 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

## UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në titullin e udhëzimit, fjala “privat” zëvendësohet me fjalën “shtetëror”.

1. Në pjesën hyrëse të udhëzimit, hiqet baza ligjore që referon paragrafin e parë të nenit 47 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

2. Në shtojcën nr.1, në tabelën B, në ndarjen “Tarifa për veprime që kryhen nga përmbartuesi gjyqësor shtetëror dhe privat”, hiqen fjalët “dhe privat”.

3. Tarifat e përcaktuara në tabelën B të shtojcës nr.1, zbatohen vetëm për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I DREJTËSISË**  
**Bujar Nishani**

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Ridvan Bode**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.4.2011  
Doli nga shtypi më 7.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë